REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALBANA XH. SPAHIU
ADRESA NR.9, HAXHI HYSEN
DALLIU, NR.59, NR.11
TEL: 672530602

# KONTRATE SHITJE PASURI E LUAJTSHME

Nr. repertori: 714 Nr. koleksioni: 213

Tirane më 03/04/2020

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Per Noterine"

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë

A202005100009055309

TAKSA E PULLES U LIKUJDUA

A2020051000009055309

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (KUOTA SHOQERIE)

Sot, më datë 03/04/2020, para meje Notere ALBANA XH. SPAHIU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën TIRANE, NR.9, HAXHI HYSEN DALLIU, NR.59, NR.11, u paraqit personalisht:

- **Shoqëria "IRZ" Shpk**, një shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqiperisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT J72207019C, me seli ne Rr. Don Bosko, Shqiperi, perfaqesuar nga Administratori Z. Ilir Biba, shtetas shqiptar, atesia Ramazan, lindur me 01/10/1986, ne Selishte, Diber dhe banues ne Tirane, mbajtes i Pasaporte Biometrike me nr.BF1443174 dhe nr. personal I61001012J, madhor e me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

*në vijim referuar si "**Shitësi**" dhe/ose "**IRZ Shpk**"*

dhe

- **Shoqëria"SELISHTE" shpk**, shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqiperisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K86921702N, me seli ne Selishte, Diber, Shqipëri, shoqëri konçesionare e themeluar në përputhje me Kontratën e Konçesionit të lidhur ndërmjet METE (Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Shitësit me Nr.1108 Rep, Nr. 195 Kol, date 19/05/2008, Noter Julian Zhelegu, e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Ramazan Biba, shtetas shqiptar, i biri i Zenel, lindur me 01/05/1955, ne Qafmurrë, Diber dhe banues ne Tiranë, mbajtes i Pasaporte Biometrike me nr. BR8003070 dhe nr. personal F50501298I, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

*në vijim referuar si "**Shoqëria Konçesionare**" dhe/ose "**SELISHTA**" **Shpk***

dhe

- **Shoqeria "CROM - Albania" Shpk**, shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqiperisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NUIS K62307003T, me seli ne Selishte, Diber, Shqiperi, perfaqesuar nga Administratore Z. Hane Doda, shtetase shqiptar, e bija e Jasharit, lindur me 20/12/1963, ne Krajke, Diber dhe banues ne Tirane, mbajtese e Pasaporte Biometrike me nr. BB3339235 dhe nr. personal G36220186M, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar,

*në vijim **CROM ALBANIA Shpk** do te referohen si "**Blerësi**"*

Në këtë marrëveshje, Shitësi, Shoqëria Konçesionare dhe Blerësi, do t'u bëhet referim së bashku si "Palët" ose veçmas si "Pala Shitese", "Pala Blerese", "Shoqeria Koncensionare".

## MEQENËSE:

A. Shoqeria Konçesionare gëzon të drejtat e detyrimet e koncesionit për ndertimin, operimin dhe transferimin e Hidorecentralit "Selishta" tek Auteriteti Kontraktues, ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e nergjise elektrike, ne zbatim te kontrates se koncesionin Nr. 1108 Rep. Nr. 195 Kol. date 19/05/2008, Noter Julian Zhelegu, (në vijim referuar edhe si "**Kontrata e Koncesionit**");

B. Shoqeria **IRZ shpk** referuar si **Shitesi** eshte zoteruese e 80% te kuotave te shoqerise koncesionare Selishte shpk dhe shepqeria **CROM - ALBANIA shpk** referuar si **bleresi** eshte zoterues e 20 % te

kuotave te shoqerise koncesionare SELISHTE shpk.

C. Shitësi është i interesuar t'i shesë Blerësit nje pjese te kuotave te zoteruara ne kapitalin e Shoqërise Konçesionare: Selishte shpk, konkretisht 31 % te kuotave;

D. Blerësi eshte i interesuar të blejë nga Shitësi nje pjese te kuotave te kapitalit të Shoqërisë Konçesionare Seloshte shpk, konkretisht 31 % te kuotave;

E. Për këtë qëllim, Palët dëshirojnë të bashkëpunojnë për të bërë të mundur realizimin e transaksionit të mësipërm, sipas parashikimeve të kësaj Marrëveshje;

*Duke pasur parasysh parashtrimet e mësipërme, Palët bien dakord si vijon:*

## Neni 1
## Kushtet paraprake dhe shtojcat

1.1 Kushtet paraprake dhe shtojcat janë pjesë përbërëse dhe plotësuese e kësaj Marrëveshje.

## Neni 2
## Objekti i Marrëveshjes

2.1 Shitësi merr përsipër te shesë dhe Bleresi angazhohet te blejë gjithsej 31% te kuotave te kapitalit të Shoqërisë Koncesionare sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara më poshtë .
Perfitimi i kuotave ne favor te bleresit, behet duke marre ne konsiderate kostot e Projektit te njohura e te miratuara nga Palet.

## Neni 3
## Çmimi dhe mënyra e pagesës

3.1 Çmimi total i shitjes së 31% te kuotave te kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Shoqërinë Koncesionare është **40,300,000 Leke** (dyzete milion e treqind mije Leke) dhe do te paguhet me keste nga Bleresi ne favor te Shitesit nepermjet FIBANK Albania, si vijon:

- **Kësti i Parë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2020;
- **Kësti i Dytë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2021;
- **Kësti i Tretë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2022;
- **Kësti i Katërt:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2023;
- **Kësti i Pestë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2024;
- **Kësti i Gjashtë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2025;
- **Kësti i Shtatë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2026;
- **Kësti i Tetë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2027;
- **Kësti i Nëntë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2028;
- **Kësti i Dhjetë:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2029;

3.2 Gjate periudhes se operimit te HEC Selishta pas marrjes se paketes kontrolluese nga CROM - ALBANIA shpk, te ardhurat e perfituara nga operimi i HEC Selishta do te perdoren:

1. Per shlyerjen e vleres se kredise ne emer te shoqerise Selishta shpk prane FIBANK etj.
2. Teprica e fondit, per cdo vit, midis te ardhurave dhe shpenzimeve te shoqerise SELISHTE shpk do te perdoret per investime ne veper ose terheqje e fitimit nga ortaku CROM - ALBANIA shpk
3. Pas shlyerjes totalisht te vleres se kredise se shoqerise SELISHTE shpk, ortaku CROM - ALBANIA shpk do te terheqe pjesen e vet te fitimit te perdorur nga kuotat e veta per shlyerjen e kredise. Vetem pasi te realizohen keto kushte ortaku I.R.Z. shpk do te filloje te arketoje nga fitimi sipas kuotave ne shoqerine SELISHTE shpk. Rakordimet do te behen ne baza mujore mes ortakeve, dhe keto rakordime do te jene AKTI mbi te cilin do te bazohen llogarite per shperndarjen e fitimit.
4. Menyra e perllogaritjeve sipas ketij shembulli ilustrues:

| | |
|---|---|
| 1. Te ardhura nga shitja | 50,000,000 ALL |
| 2. Shpenzime (a+b+c) | 15,000,000 ALL |
| a. Paga + Sig shoq | 7,000,000 ALL |
| b. Shpenzime Operative | 7,000,000 ALL |

| | |
|---|---|
| e. Tatim Fitimi | 1.000.000 ALL |
| 3. Teprica e Fondit (1-2) | 35.000.000 ALL |

**Neni 4**

**Deklarimet dhe garancite e Shitësit**

4.1 Pala Shitëse deklaron dhe garanton se:

a. do të bashkëpunojë, ofrojë ndihmën e nevojshme dhe do të vërë në dispozicion të Blerësit si edhe të personave të caktuar prej tij të gjithë informacionin dhe dokumentacionin (përfshirë autorizimet dhe pëlqimet e nevojshme) për të mundësuar kontrollin efektiv të Shoqërisë Koncesionare.

b. nuk do të negociojë, bisedojë apo kontaktojë me të tretë për kalimin e kuotave të Shoqërisë Koncesionare apo të të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Koncesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, Shitësi i Ardhshëm, gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje, nuk do të marrë përsipër, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, angazhime apo detyrime të tashme apo të ardhshme, nuk do të nënshkruajë marrëveshje, kontrata, dhe në përgjithësi nuk do të kryejë asnjë veprim që ka si qëllim kalimin të tretëve të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga Kontrata e Koncesionit, me ose pa kundërshpërblim.

**Neni 5**

**Deklarimet dhe garancite e Shitësit**

Pala Blerëse deklaron dhe garanton se do te respektoje kushhtet dhe afatet e pagesave te percaktuara me lart.

**Neni 6**

**Afati i Kontrates**

7.1 Kjo Marrëveshje është detyruese për Palët dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre nga data e nënshkrimit të saj deri ne datën qe përkon ne daten e likuidimit total te shumes se kontrates.

**Neni 7**

**Penalitete dhe zgjidhja e Marrëveshjes**

8.1 Asnjëra prej palëve nuk mund të zgjidhë këtë Marrëveshje ne mënyrë te njëanshme pa shkaqe te arsyeshme. Në rast ndonje nga palët zgjidh pa shkak kete marreveshje, atëherë do te jete përgjegjësepër demin e shkaktuar palëstjetër.

**Neni 8**

**Të ndryshme**

7.1 Pavlefshmëria e një apo më shumë parashikimeve të kësaj Marrëveshje nuk do të ketë pasoja ose nuk do të cënojë vlefshmërinë e parashikimeve të tjera të saj, të cilat do të jenë në fuqi dhe do të prodhojnë pasoja juridike, përveç kur cënohet vlefshmëria e kushteve thelbësore të Marrëveshjes. Palët marrin përsipër të zëvendësojnë dispozitat e pavlefshme me dispozita të tjera të vlefshme, duke ruajtur thelbin dhe kuptimin e kësaj Marrëveshje.

7.2 Kjo Marrëveshje dhe çdo e drejte që buron nga ajo nuk mund t'iu kalohet të tretëve pa miratimin paraprak me shkrim të të gjithë Palëve.

7.3 Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje do të jenë të vlefshme dhe detyruese për Palët vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga të gjitha Palët.

7.4 Nëse ndonjë nga Palët nuk i referohet një parashikimi të kësaj Marrëveshje ose nuk ushtron një të drejtë, në asnjë rast kjo sjellje nuk do të konsiderohet si dorëheqje nga ky parashikim ose nga ushtrimi i kësaj të drejte, dhe kjo sjellje nuk mund të cënojë vlefshmërinë e kësaj Marrëveshje. Dorëheqja nga të gjitha Palët e ushtrimit të një të drejte apo dispozite nuk do të pengojë këtë Palë të ushtrojë më vonë këtë të drejtë apo t'i

referohet më vonë kësaj dispozite, në kuptim të kësaj Marrëveshje.

7.6 Palët bien dakord të mbajnë të fshehtë këtë Marrëveshje, negocimet dhe të gjitha çështjet që rregullohen nga kjo Marrëveshje.

7.7 Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga ligji shqiptar. Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes Palëve do të zgjidhen miqësisht mes tyre brenda një afati prej 30 ditësh nga lindja e mosmarrëveshjes ose nga data në të cilën është komunikuar me shkrim nga njëra prej Palëve. Në rast se këto mosmarrëveshje nuk zgjidhen miqësisht mes Palëve, gjykata kompetente për gjykimin e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7.8 Kjo kontrate shtrin efektet edhe tek trashegimtaret ligjore te paleve kontraktore.

7.9 Kjo marrëveshje hartohet dhe nënshkruhet nga Palët në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe.

**NENI 9**

**Forcat madhore**

Në rast se ndonjë nga palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë të cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore.

Sa me siper hartohet kjo kontrate prej meje Noteres ne 4 (kater) kopje te njejta dhe identike, ne mbeshtetje te neneve 79, 80, 81, 82, 659, 660, 662, 663, 676, 678, e vijues Kodit Civil, Ligjit nr.110, date 20.12.2018 "Per Noterine", Ligjit per shoqerite tregtare, Ligjit per koncensionet ne RSH, i lexohet paleve me ze te larte, te cilet pasi e gjeten te redaktuar aktin noterial konform vullnetit te tyre te lire, e nenshkruajne rregullisht ne pranine time.

*Kjo kontratë iu lexohet palëve me zë të lartë e të qartë dhe pasi palët e gjejnë kontratën në përputhje me vullnetin e tyre të plotë e te lirë e nënshkruajnë rregullisht kontratën para meje Noteres. Unë Noterja e vërtetoj atë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërise.*

Palët deklarojnë kanë dhënë pëlqimin, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pra për trajtimin e tyre nga unë noterja si dhe nxjerrje te dokumentacionit te nevojshem nga portalet shteterore.

| **SHITËSI** | **BLERËSI** |
|---|---|
| **IRZ Shpk** | **CROM ALBANIA Shpk** |

**Shoqëria Konçesionare**

**Si dhenese pelqimi**

**SELISHTE Shpk**

**NOTERE**

**ALBANA XH. SPAHIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K62307003T | |
| 2. Data e Regjistrimit | 11/05/2006 | |
| 3. Emri i Subjektit | CROM - ALBANIA | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 11/05/2006 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 11/05/2006 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Diber Selishte SELISHTE Salla e Makinerive, Hidrocentrali Selishte ne Perroin e Madh, Selishte Diber | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import eksport,tregetim me shumice dhe pakice te: Tuba e gypa metalike te dimensioneve te ndryshme, kabllo elektrik dhe telefonik te llojeve dhe dimensioneve te ndryshme, metale si: çelik, hekur, bronx, baker, alumin, lende te para, pllaka dhe paisje hidraulike, hidrosanitare e termosanitare, mallra industriale, lendeve te para e materialeve te ndertimit si dhe makineri ndertimi dhe pjese kembimi per to. | |
| 10. Administratori/ët | Hane Doda | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 24/07/2017 | Deri: 24/07/2022 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | HaneDoda | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 100.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 100,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 100,00 | |
| | | |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K86921702N | |
| 2. Data e Regjistrimit | 21/07/2008 | |
| 3. Emri i Subjektit | SELISHTE | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 05/07/2008 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 05/07/2008 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Diber Selishte SELISHTE Salla e Makinerive, Hidrocentrali Selishte ne Perroin e Madh, Selishte, Diber | |
| 8. Kapitali | 6.600.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Objekti i vetem i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Kontraten e Koncesionit me Nr. 1108 Rep. e Nr. 195 Kol., date 19.05.2012, do te jete : Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Selishte tek Autoriteti Kontraktues, ku perfshihet financimi, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike ne zbatim te kesaj Kontrate Koncesioni. | |
| 10. Administratori/ët | Hane Doda | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 09/03/2020 | Deri: 09/03/2025 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | I. R. Z. | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 5.280.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 1,00 | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| | 80,00 | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Ortakët<br>13.1 Vlera e kapitalit<br>13.2 Numri i pjesëve<br>13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | CROM - ALBANIA | |
| | Para: 1.320.000,00 | Natyre: |
| | 1,00 | |
| | 20,00 | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: SELISHTE<br>E-Mail: prelajjozef@gmail.com<br>Telefon: 0692055992 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 15/04/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2020/04/15 14:27:39 +02'00'
K86921702N20200415142731072006



Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | J72207019C | |
| 2. Data e Regjistrimit | 01/10/1997 | |
| 3. Emri i Subjektit | I. R. Z. | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 08/03/1994 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 08/03/1994 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 9, Pallati Ish te Perndjekurit Politik, Kati i pare, Zona Kadastrale 8310 | |
| 8. Kapitali | 110.000.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 100,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Import eksport,tregtimin me shumice e pakice te artikujve te ndryshem,te konsumit te gjere,industrial e ushqimore.Prodhimin e materialeve te ndertimit, ndertimin e objekteve me karakter social e publik, investime ne fushen e ndertimeve.Importimin dhe eksportimin e makinerive,paisjeve dhe pjeseve te nderrimit.Transport mallrash dhe udhetaresh.Nxjerrje,perpunim dhe tregtim i mineraleve te ndryshme.Perpunim dhe tregtim i lendes drusore.Studim,projektim,ndertim,montim dhe operator i prodhimit te energjise elektrike,ndertim hidrocentralesh te rinj,rehabilitim hidrocentralesh ekzistuese,prodhim,tregtim,transmetim,transferim,shperndarje,eksportim,shitje te energjise elektrike. | |
| 10. Administratori/ët | Ilir Biba | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 24/08/2017 | Deri: 24/08/2022 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |

Kopje nga web

VENDIM nr. 1

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
"CROM-ALBANIA" Sh.p.k

Date 24/03/2020

Shoqeria "CROM-ALBANIA" SHPK eshte person juridik shqiptar, i rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me NIPT K62307003T.
Kapitali themltar i shoqerise eshte 100.000.00 leke dhe zoterohet nga Ortaku i vetem Z.Hane Doda.
Sot me dt.24/03/2020 eshte mbledhur ortaku i vetem i shoqerise qe perfaqeson 100% (njeqind per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise CROM ALBANIA, per te diskutuar e vendosur lidhur me rendin e dites:
Rendi i dites eshte:

1) Miratimi i blerjes se kuotave te shoqerise SELISHTE shpk;
2) te tjera eventuale;

Pasi analizoi pikat e rendit te dites, ne baze te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe ne baze te Statutit te Shoqerise, ortaku i vetem:

**VENDOSI:**

**1)** Te miratoje blerjen e kuotave qe perfaqsojne 31 % te kapitalit te zoteruara nga shoqeria LRZ ne kapitalin e shoqerise koncensionare SELISHTE sh.p.k tek bleresi CROM- ALBANIA sh.p.k. sipas kushteve dhe afateve te percaktuara si me poshte. Vlera e kuotave eshte 40.300.000 leke,dhe do te paguhet me keste nga Bleresi ne favor te Shitesit nepermjet FIBANK Albania, si vijon:

| | |
|---|---|
| **- Kesti i Pare:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2020; |
| **- Kesti i Dyte:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2021; |
| **- Kesti i Trete:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2022; |
| **- Kesti i Katert:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2023; |
| **- Kesti i Peste:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2024; |
| **- Kesti i Gjashte:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2025; |
| **- Kesti i Shtate:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2026; |
| **- Kesti i Tete:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2027; |
| **- Kesti i Nente:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2028; |
| **- Kesti i Dhjete:** | 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2029; |

**2)** Te autorizoje administratorin e shoqerise per te perfaqesuar shoqerine ne thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes se asamblese se shoqerise SELISHTE sh.p.k., ku do te miratohet transferimi i kuotave si me siper;
**3)** Te depozitoje kete vendim ne QKB Tirane dhe ne cdo autoritet tjeter sipas kerkesave te ligjit shqiptar.

Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku i vetem.

**Autorizohet Znj. Hane Doda**, me nr. personal G35220186M, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te kryeje procedurat prane QKB per regjistrimin ketij Vendimi dhe Kontraten e Shitjes se Kuotave.

**ORTAKU I VETEM**

Hane Doda

Hane Doda

REPUBLIKA E SHQIPERISE
CROM ALBANIA shpk Import Export
ALBANIA

**Dt. 24.03.2020**

# VENDIM Nr. 1

## I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE "I.R.Z" sh.p.k

Shoqeria "I.R.Z" SHPK eshte person juridik shqiptar, i rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit me NIPT J72207019C. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 110.000.000.00 Leke dhe zoterohet nga ortaku i vetem z. Ramazan Biba. Administrator i shoqerise eshte z. Ilir Biba.

Sot me dt.24/03/2020 eshte mbledhur ortaku i vetem i shoqerise qe perfaqeson 100% (njeqind per qind) te kapitalit themeltar te shoqerise I.R.Z, per te diskutuar e vendosur lidhur me rendin e dites:

**Rendi i dites eshte:**

1. Shitja e 31% te kuotave te zoteruara nga shoqeria I.R.Z ne kapitalin e shoqerise SELISHTE shpk;
2. Te tjera eventuale;

Pasi analizoi pikat e rendit te dites, ne baze te ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe ne baze te Statutit te Shoqerise, ortaku i vetem:

**VENDOSI:**

1. Te miratoje shitjen e kuotave qe perfaqesojne 31 % te kapitalit te zoteruara nga shoqeria I.R.Z ne kapitalin e shoqerise koncensionare SELISHTE sh.p.k tek bleresi CROM- ALBANIA sh.p.k. sipas kushteve dhe afateve te percaktuara si me poshte:
   Vlera e 31 % te kuotave te shoqerise SELISHTE shpk eshte vleresuar 40.300.000 leke, dhe do te paguhet me keste nga Bleresi ne favor te Shitesit si vijon:
   - **Kesti i Pare:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2020;
   - **Kesti i Dyte:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2021;
   - **Kesti i Trete:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2022;
   - **Kesti i Katert:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2023;
   - **Kesti i Peste:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2024;
   - **Kesti i Gjashte:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2025;
   - **Kesti i Shtate:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2026;
   - **Kesti i Tete:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2027;
   - **Kesti i Nente:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2028;
   - **Kesti i Dhjete:** 10% e shumes ne (4,030,000 Lek) fund te vitit 2029;

2. Te autorizoje administratorin e shoqerise per te perfaqesuar shoqerine ne thirrjen dhe mbajtjen e mbledhjes se asamblese se shoqerise SELISHTE sh.p.k., ku do te miratohet transferimi i kuotave si me siper;

3. Te depozitoje kete vendim ne QKB Tirane dhe ne cdo autoritet tjeter sipas kerkesave te ligjit shqiptar. Lexuar, aprovuar e nenshkruar nga ortaku i vetem.

**<u>Autorizohet</u> Znj. Hane Doda**, me nr. personal G36220186M, madhore, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, te kryeje procedurat prane QKB per regjistrimin ketij Vendimi dhe Kontraten e Shitjes se Kuotave.

**ORTAKU I VETEM**

RAMAZAN BIBA

I.R.Z. sh.p.k. Import - Export NUIS: J72207019C TIRANË - ALBANIA

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX. 355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@rcen-al.com

Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit | D-202003079272416 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 07.03.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 9:27:24AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-479-282 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

ILIR RAMAZAN BIBA
I. R. Z. SH.P.K

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE
R.B.S.
TIRANE - ALBANIA

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK.
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@qkr-al.com

Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2020030793030647 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 07.03.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 9:30:30AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-479-283 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

HANE JASHAR DODA
CROM - ALBANIA SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK "Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@rbs-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

### INFORMACION I PËRGJITHSHËM :

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit të Kërkimit: | D-2020030792552511 |
| Data e Rezultatit të Kërkimit: | 07.03.2020 |
| Ora e Rezultatit të Kërkimit: | 9:25:52AM |
| Lloji i Kërkimit: | Emri i Personit Juridik |
| Kriteri i Kërkimit: | (EM) SELISHTE SH.P.K. |
| Numri i Dokumentit: | D-400-479-284 |
| Referenca e Përdoruesit: | |

**NUMRI I REZULTATEVE TE GJETURA SIPAS :**

(EM) SELISHTE SH.P.K. ËSHTË 2

************************** REGJISTRIMI - A-20130613155405937 *****************************

| | |
|---|---|
| Data e regjistrimit | 13.06.2013 |
| Ora e regjistrimit | 3:54:05PM |
| Kohezgjatja e Regjistrimit (vite): | 13 |
| Data e Përfundimit të Regjistrimit | 13.06.2026 |
| Numri i Dokumentit: | A-323-001-332 |
| Referenca e Përdoruesit: | |

BARRËMARRËSI (Kreditori):

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) BANKA E PARE E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A | Adresa: DESHMORET E KOMBIT, KULLAT BINJAKE, 2/14<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 2276758<br>Fax: 2280210<br>Email: J.GJATA@FIBANK.AL |

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE SHQIPERI
TEL/FAX:355 4 2420006
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@rben-al.com

# Regjistri i Barrëve Siguruese

**BARRËDHËNËSI (Debitori):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) SELISHTE SH.P.K. | Adresa: SELISHTE K86921702N<br>SELISHTE-DIBER<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**MALLRA ME NUMER SERIE:**

| Nr. i Serise | Prodhuesi | Viti |
|---|---|---|

**KOLATERAL PERSHKRIM:**

ASETET E HIDROCENTRALIT, PERFSHIRE 2 TURBINAT BASHKE ME SETET E TYRE TE CILAT JANE PJESE PERBERESE E 26 PAJISJEVE TURBINASH SIPAS MARREVESHJES NR.1823REP./NR.538 KOL.DT.28.05.2013.

**PERSONI REGJISTRUES:**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| | Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**NËNSHKRIMI I AUTORIZUAR :**

Emri dhe Mbiemri
AIDA AJDIN

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20130613155405937**

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK "Savia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@rben-al.com

****************************** REGJISTRIMI - A-20130613155551340 ******************************

| | |
|---|---|
| Data e regjistrimit: | 13.06.2013 |
| Ora e regjistrimit: | 3:55:51PM |
| Kohezgjatja e Regjistrimit (vite): | 13 |
| Data e Përfundimit te Regjistrimit: | 13.06.2026 |
| Numri i Dokumentit: | A-323-001-331 |
| Referenca e Përdoruesit: | |

**BARRËMARRËSI (Kreditori):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) BANKA E PARE E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A | Adresa: DESHMORET E KOMBIT, KULLAT BINJAKE, 2/14<br>TIRANE-TIRANE<br>SHQIPERI<br>Tel: 2276758<br>Fax: 2280210<br>Email: J.GJATA@FIBANK.AL |

**BARRËDHËNËSI (Debitori):**

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
|---|---|
| (EM) SELISHTE SH.P.K. | Adresa: SELISHTE K86921702N<br>SELISHTE-DIBER<br>SHQIPERI<br>Tel:<br>Fax:<br>Email: |

**MALLRA ME NUMER SERIE:**

| Nr. i Serise | Prodhuesi | Viti |
|---|---|---|

**KOLATERAL PERSHKRIM:**

TE ARDHURAT E BARREDHENESIT QE BUROJNE NGA KONTRATA PER SHITBLERJE ENERGJIE ELEKTRIKE ME "KESH"SHA ME NR.4071 PROT.DT.12.09.2012 ME AFAT 15 VJET.

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX. 355 4 2420005
TEL 355 4 2420006
Email: rbs@rben-al.com

PERSONI REGJISTRUES:

| Emri i Personit Fizik/Juridik | Adresa |
| --- | --- |
| | Tel:<br>Fax:<br>Email: |

NOTER T. SPAHIU TIRANË

NENSHKRIMI I AUTORIZUAR :

Emri dhe Mbiemri

AIDA AJDIN

**FUNDI I REGJISTRIMIT - A-20130613155551340**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX: 355 4 2420006
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roem-al.com

Fundi i Rezultatit të Kërkimit:

Fundi i Dokumentit

Rr. e Dibres, Cendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX 355 4 2420005
TEL 355 4 2420006
Email: rbs@rben-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20200307925525 11 |
| Date e Rezultatit te Kerkimit: | 07.03.2020 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 9:25:52AM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-479-284 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

RAMAZAN ZENEL BIBA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER BELINDA V. ÇELAJ
ADRESA NR.5, ISMAIL QEMALI,
NR.3/118
TEL: 692077776

# DEKLARATE ME PERMBAJTJE TE TJERA

Nr. repertori: 594 Nr. koleksioni: 290

Tirane më 24/03/2020

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, date 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, date 20/12/2018 "Për Noterinë"

A20200531001308922I

* Akti noterial përbëhet nga 2 fletë

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE**
**ZYRA VENDORE** Tirane
**NR.** 574 **REP.**
**NR.** 170 **KOL.**

**DEKLARATE NOTERIALE**

***Per dhenie pelqimi per kalimin e kuotes qe perfaqeson 31% (tridhjete e nje perqind) perqind te kuotave te shoqerise Selishte shpk te ortakut I.R.Z. shpk tek shoqeria Crom Albania shpk***

Ne Tirane, sot me date 24.03.2020, perpara meje Blinda Celaj, noter prane Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht perfaqesuesit ligjore te Bankes se Pare te Investimeve – Albania ShA, me adrese: Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla II, Kati 14-15, Tirane, e regjistruar si person juridik, me Vendim te Gjykates te rrethit Tirane №35506, dt.19.04.2006, NIPT K72014801J, perfaqesuar rregullisht nga znj. **Elma Lloja**, shtetase Shqiptare, ne cilesine e Drejtores Ekzekutive dhe znj. **Ina Paskaleva**, shtetase Bullgare, ne cilesine e Drejtores se Menaxhimit te Riskut, te dyja madhore, me zotesi te plote per te vepruar, te quajtur ne vijim "**BANKA**" deklarojne sa me poshte:

Me Kontraten e Kredise Bankare Nr. 2444 Rep. / Nr. 632 Kol. date 20.06.2013, te lidhur ndermjet, kredimarresit shoqerise Selishte shpk me NIPT K86921702N, dorezaneseve shoqerise I.R.Z. shpk me NIPT J72207019C, shoqerise Crom – Albania shpk me NIPT K62307003T dhe shtetaseve Ramazan Zenel Biba, Ilir Ramazan Biba dhe Nahile Selman Biba, i eshte akorduar nga kredidhenesi Banka e Pare e Investimeve – Albania ShA, nje kredimarresi ne vleren totale prej Leke 165'000'000 (njeqind e gjashtedhjete e pese milion leke).

Per sigurimin e kredive te siperpercituara, eshte vene Barre Siguruese ne rradhe te pare me ane te Marreveshjes Siguruese Nr. 2445 Rep. / Nr. 633 Kol. date 20.06.2013, mbi pasurine e pershkruar si me poshte vijon:

Barre siguruese ne favor te Bankes se Pare te Investimeve – Albania ShA mbi:

a) 100% (njeqind perqind) te kuotave te shoqerise Selishte shpk me NIPT K86921702N, te pasqyruara prej shoqerise ne zerat e bilancit financiar dhe te specifikuara sipas ekstraktit te QKB-se.

Nga ana e barredhenesit shoqerise I.R.Z. shpk me NIPT J72207019C, titullare E pasurise te vendosur si barre siguruese per kredine e cituar me siper dhe te dhene nga Banka eshte kerkuar te jepet miratimi per kalimin e kuotave qe perfaqeson 31% te kapitalit te shoqerise Selishte shpk te zoteruara prej ortakut shoqeria I.R.Z. shpk me NIPT J72207019C ne emer te shoqerise Crom – Albania shpk me NIPT K62307003T dhe pasqyrimi i ketyre ndryshimeve ne qendren kombetare te regjistrit (QKR) duke ndryshuar edhe perberjen e shoqerise pas kalimit te kuotes qe perfaqeson 31% te kapitalit te shoqerise.

Bazuar ne ligjin nr. 8537 date 18.10.1999 "Per Barret Siguruese" dhe ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendreen Kombetare te Regjistrit "Banka e Pare e Investimeve - Albania ShA, ne cilesine e kredidhenesit dhe perfituesit te Barres Siguruese mbi pronen e siperpermendur, deklaron se eshte dakort dhe kerkon te behet kalimi kuotes qe perfaqeson 31% te kapitalit te shoqerise Selishte shpk te zoteruara prej ortakut shoqeria I.R.Z. shpk me NIPT J72207019C ne emer te shoqerise Crom – Albania shpk me NIPT K62307003T mbi pasurine e pershkruar me siper dhe pasqyrimi i ketyre ndryshimeve ne qendren kombetare te regjistrit (QKR) duke ndryshuar edhe perberjen e shoqerise pas kalimit te kuotes qe perfaqeson 31% te kapitalit te shoqerise te shoqerise Selishte shpk.

Per efekt shmangien e cdo keqinterpretimi, theksojme se te gjitha barret e tjera te mundshme per vendosje barre siguruese mbi pasuri te tjera mbi te cilat rendon barra siguruese ne favor te Bankes, nepermjet te cilave garantohen detyrimet e kredimarresit do te vazhdojne te ngelen ne regjistrin e barreve siguruese dhe te pasqyruara ne qendren kombetare te regjistrit (QKB) ne favor te Bankes se Pare te Investimeve – Albania ShA.

Ne asnje rast kjo deklarate nuk do te interpretohet si heqje dore e Bankes nga e drejta e barres siguruese dhe shenimeve ne QKB mbi pasurine e pershkruar me siper, e cilat do te vazhdoje te garantoje kredite e dhena nga Banka sipas kontratave te kredise si dhe te cdo veprimi tjeter juridik qe eshte garantuar nepermjet pasurise te mesiperme pavaresisht nga kalimi i kuotes qe perfaqeson 31% te kapitalit te Selishte shpk me NIPT K86921702N ne te zoteruara prej ortakut shoqeria I.R.Z. shpk me NIPT J72207019C ne emer te shoqerise Crom – Albania shpk me NIPT K62307003T dhe pasqyrimi i ketyre ndryshimeve ne qendren kombetare te regjistrit (QKB) duke ndryshuar edhe perberjen e shoqerise pas kalimit te kuotes qe perfaqeson 31% te kapitalit te shoqerise Selishte shpk.

*Une, Noteri ia lexova me ze te qarte dhe te kuptueshem znj. Elma Lloja dhe znj. Ina Paskaleva tekstin e kesaj deklarate, te njohur personalisht prej meje. Ata pasi e degjuan, me deklarojne se e kuptojne dhe se permbajtja e saj perputhet plotesisht me thenien e tyre, e nenshkruajne rregullisht ne pranine time, dhe une Noteri vertetoj kete deklarate noteriale sipas ligjit. kjo deklarate noteriale perpilohet ne tre shtypshkrime te njejta.*

**DEKLARUES**
**BANKA E PARE E INVESTIMEVE – ALBANIA SHA**

**Elma Lloja**
**Drejtore Ekzekutive**

**Ina Paskaleva**
**Drejtores se Menaxhimit te Riskut**

**Perkthyes:**

**NOTER**

*Pulla taksatore paguar sipas ligjit*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1108 Rep.
Nr. 175 Kol.

SPQIPERISE H. SPAHIU NOTER TIRANE

## KONTRATE KONCESIONI

## E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT 'SELISHTE'

Ne Tirane, me date 17, muaji korrik, viti 2008 (dy mije e tete), u paraqiten para meje notere Jolanda B. Ajdini regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese Rr. Durresit P. 118 SH1 Ap. 6, palet kontraktuese si me poshte.

**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes**, qe me poshte do te quhet **"AUTORITET KONTRAKTUES"**, percaktuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 552, date 29.08.2007, perfaqesuar me autorizimin nr. 1597/5, date 13.02.2008, nga z. Kristo Rodi, i biri i Stefanit, i datelindjes 11.06.1957, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr.Z0681338;

DHE

**Shoqerise "IRZ"** sh.p.k., regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 2656, date 10.03.1994, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne Rruga Don Bosko, perballe "parkut te autobuzeve", regjistruar ne organin tatimor me nr. Nipt J72207019C, date 22.11.2004, qe me poshte do te quhet **"Koncesionari"**, perfaqesuar nga administratori z. Ramazan Biba, i biri i Zenel, lindur me 01.05.1955, banues ne Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr. Z1685945, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

### Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permiresimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;

2. Konsideron nderimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikes se zhvillimit te sektorit te energjise.

3. Vlereson formen "BOT" te koncesionit, si nje forme koncesioni qe ben te mundur nxitjen e investitoreve private per nderimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;

4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;

5. Mirepret investitoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.

Koncesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndertimin dhe shfrytezimin e hidrocentraleve te siperpermendura, si një propozim i pakërkuar, dhe në perfundim te proçedurës përzgjedhese konkurruese eshtë vlerësuar si ofertuesi me i mirë.

2. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentralit Selishte, komuna Selishte, rrethi Diber, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;

3. Shoqeria "IRZ"sh.p.k. zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;

4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.

Palët lidhin këtë kontratë koncesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për konçesionet" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 274, date 04.05.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me konçesion të hidrocentraleve dhe bien dakort për sa më poshtë:

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1
### Perkufizime dhe interpretime

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

1.1. **Kontrata e Konçesionit** : Kjo kontratë, aneksi/anekset dhe çdo dokument tjetër qe do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.

1.2. **Ligji "Për Konçesionet"**: Ligji nr.9663 dt.18.12.2006 "Për konçesionet".

1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes.

1.4. **Konçesionari:** Shoqeria "IRZ" Sh.p.k, me seli ne rruga "Don Bosko", ne qytetin e Tiranes.

1.5. **Hidrocentral:** Hidrocentrali Selishte, me vendndodhje në komunen Selishte, rrethi Diber, me fuqi te instaluar 1,350 (njemije e treqind e pesedhjete) kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 8,400,000 (tetemilion e katerqind mije) kWh, i perbërë nga tërësia e objekteve qe sherbejne për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar ne to: veprën e marrjes, kanalin e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dergon ujin ne turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit se bashku me makinerite dhe pajisjet e instaluara në të.

1.6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndertimi, vënia në pune, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve dhe transferimi i tij nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.

1.7. **Investimi:** Vlera totale në leke që do të shërbeje per ndërtimin dhe paisjen me makinerite e nevojshme të Hec-it, deri në fillimin e prodhimit të energjise elektrike.

1.8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe venien ne punë te hidrocentralit Selishte, ne perputhje me projektin e zbatimit.

1.9. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.

1.10. **Vënia në punë e hidrocentralit:** Fillimi i prodhimit te energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.

1.11. **Kontratat:** Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Koncesionari, me sipermarresit per realizimin e punimeve ose cdo marreveshje tjeter e lidhur me te tretet që ka si objekt operimin e hidrocentralit dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.

1.12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, qe leshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektit te kesaj kontrate, bazuar ne legjislacionin ne fuqi.

1.13. **Operimi:** Te gjitha veprimet e koncesionarit per prodhimin, furnizimin, transmetim, shperndarje, eksportim dhe shitje te energjise elektrike, ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

1.14. **Tarifa konçesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur ne përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.

1.15. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me dite, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javes së fundit ose të muajit te fundit që ka të njëjtin emër ose numer me atë të dites numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon ne muajin e fundit afati mbaron me kalimin e dites se fundit te këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie ne ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punes, që vjen pas asaj të pushimit.

1.16. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatoreve në bazë të legjislacionit shqiptar.

1.17. **Sigurimi i kontrates:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në raster e shkeljes së kontrates nga Konçesionari, sipas Nenit 14.

1.18. **Ligj:** Nenkupton cdo ligj organik, dekret, vendim i Keshillit te Ministrave ose cdo ligj tjeter qe shpallet si i tille, rregullore, udhezim, urdher, license, leje, autorizim ose cdo akt tjeter ligjor i shpallur nga Republika e Shqiperise, vendime gjyqesore qe kane karakter unifikues, akte zyrtare te leshuara nga cdo organ qendror dhe/ose vendor, ashtu sic mund te ndryshojne gjate kohezgjatjes se kesaj Kontrate.

1.19. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003.

1.20. **Aneks:** Çdo deklarate, vertetim, autorizim, vendim, urdher ose dokument tjeter i nenshkruar nga palet qe i bashkelidhet kesaj Kontrate, si pjese perberese dhe e pandare e saj, tani apo ne te ardhmen.

## Neni 2
## Objekti i Konçesionit

2.1 Objekti i kesaj kontrate konçesioni eshte :

Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve te kesaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Per konçesionet", i jep Koncesionarit me koncesion te formës BOT (që do te thotë ndertim, operim dhe transferim i se drejtës së pronësisë dhe operimit, ne përfundim te kontrates së koncesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit Selishte dhe transferimin e tij në perfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

## Neni 3
## Karakteristikat e hidrocentralit

3.1 Hidrocentrali Selishte do të ndërtohet mbi perrenjte Perroi i Madh dhe Qafe Murres, ne fshatin Selishte, komuna Selishte, rrethi Diber, me këto karakteristika:

- Kuotat e vepres:

- Kuota e vepres se marrjes 736 m
- Kuota e godines se centralit 645m
- Fuqia e Instaluar 1,350 kW
- Prodhimi i energjisë elektrike 8,400,000 kWh

## Neni 4
## Kohëzgjatja e Kontratës së Konçesionit

4.1 Autoriteti Kontraktues i jep Konçesionarit me konçesion te formes "BOT", ne perputhje me nenin 2, me siper, hidrocentralin për një periudhë 35 vjeçare.

4.2 Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashket mund të zgjasin afatin e kesaj kontrate, kur vleresohet se, nga ana e Konçesionarit janë permbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.

4.3 Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj Kontratës.

## KREU II
## TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

### Neni 5
### Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

5.1 Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore (ku perfshihen po nuk kufizohen toka ku do te ndertohen hidrocentrali, toka ku shtrihet shtrati natyror i perrenjve, toka ne te dy anet e argjinaturave) qe do t'i sherbejne objektit te kontrates se koncesionit, gjate gjithe kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues ose organit te administrates qendrore sic mund te parashikohet ndryshe gjate kohezgjatjes se Kontrates.

5.2 Konflikte mbi titullin e pronesise

Ne rast konflikti mbi titullin e pronesise, ne perputhje me paragrafin e mesiperm, Autoriteti Kontraktues merr persiper t'i zgjidhe ato, per ti garantuar Koncesionarit shfrytezimin e qete dhe pa pengesa.

### Neni 6
### Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

6.1 Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejte qe ne periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhes se koncesionit, nëpërmjet të autorizuarve te tij, të monitorojë objektin e koncesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithate, Autoriteti Kontraktues mund te ushtroje kete monitorim ne cdo kohe ne rast se ka informacione te arsyeshme dhe te besueshme ne lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve te kesaj Kontrate.

6.2 Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka te drejtë të ushtrojë një mbikqyrje te përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe vënies ne punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe te dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Koncesionari do te njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

### Neni 7

## Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr persipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontrates pavaresisht ndryshimeve te objektivave strategjikë kombëtar dhe të sektorit.

2. Të ndihmojë Koncesionarin pranë çdo institucioni shteteror dhe organi vendor, kur eshte e nevojshme per marrjen e licencave ose lejeve që do t'i sherbejne për ekzekutimin e punimeve dhe implementimit e kesaj kontrate.

3. Te miratoje projektin e Zbatimit te hidrocentralit, te pergatitur nga vete Koncesionari, ne perputhje me propozimin per te cilin eshte shpallur fitues ne proceduren e gares.

4. Të ndihmojë Konçesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime te realizimit të objektit të kesaj kontrate.

5. Te garantoje, nese kerkohet nga Koncesionari, detyrimin e subjektit te furnizimit te energjise elektrike per te blere energjine elektrike te prodhuar nga keto hidrocentrale, nepermjet nenshkrimit te nje kontrate te posaçme. Kohezgjatja e kesaj kontrate do te jete per nje periudhe kohore prej jo me pak se 4 vjet dhe e rinovueshme ne rast se kerkohet nga Koncesionari. Rinovimi i kesaj kontrate mund te kerkohet deri ne 4 here dhe pertej ketij numri, Koncesionari do te negocioje me subjektin e furnizimit te energjise elektrike. Çmimi i shitjes se energjise elektrike të prodhuar nga kjo kategori hidrocentralesh do te llogaritet nga Enti Rregullator i Energjise.

6. Të garantojë Konçesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit te Koncesionarit.

7. Autoriteti Kontraktues me kerkese te Koncesionarit merr persiper te beje te gjitha perpjeket per te asistuar kete te fundit tek organet shteterore per cdo pengese qe mund te haset ne kuader te pajisjes me leje, licensa, autorizime apo cdo lloj tjeter leje qe nevojitet per operimin e kesaj vepre. Ky parashikim nuk eshte i zbatueshem kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospermbushjes se kerkesave ligjore perkatese per shkak te Koncesionarit

8. Autoriteti Kontraktor eshte pergjegjes per detyrimet ligjore dhe kontraktore ne rast te mospermbushjes se ketyre detyrimeve nga ana e tij duke shperblyer te gjitha demet e shkaktuara ndaj Koncesionarit dhe qe kane te bejne me Kthimin e Vleres se Investimit te kryer (vlera e aseteve ne momentin zgjidhjes se kontrates), sigurimin e kontrates (nese ka) dhe shperblimin e demit per shkak te shkeljes se Kushteve te percaktuara ne kontraten e koncesionit.

## KREU III
## TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONÇESIONARIT

## Neni 8
## Detyrimet e Konçesionarit

8.1 Konçesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanerisht Konçesionari duhet që:

1. Të themelojë brenda 30 (tridhjete) ditësh nga hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit, shoqërinë konçesionare, që do të ketë si objekt te veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, operimin, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit dhe transferimin e tij ne perfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues, ne zbatim te nenit 2, te kesaj Kontrate.

Shoqëria e krijuar do t'i nenshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqerive tregtare ne Shqipëri, duke patur parasysh qe te gjitha te drejtat dhe detyrimet e parashikuara ne kete kontrate per Koncesionarin do ti mbeten ketij te fundit deri ne perfundim te kesaj Kontrate.

Nje kopje e aktit te themelimit, statutit dhe regjistrimit te shoqerise se re si person juridik, do ti dorezohet Autoritetit Kontraktor brenda 10 diteve nga data e regjistrimit, per te marre miratimin e ketij te fundit, duke patur parasysh qe miratimi i ketij te fundit te jepet brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se dokumentit perkates. Ne rast vonese per shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktor nuk ka verejtje apo sugjerime ne lidhje me themelimin e personit te ri juridik.

Ne menyre te vecante kerkohet qe statuti te permbaje te pakten:

i. Forma e shoqerise: Forma e shoqerise do te jete "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose "shoqeri anonime", duke funksionuar ne zbatim te ligjit nr. 7638, date 19.12.1992, "Per Shoqerite Tregtare";

ii. Objekti i shoqerise: Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Selishte tek Autoriteti Kontraktues, ku perfshihet financimi, ndertimit, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike, ne zbatim te kesaj Kontrate Koncesioni. (Nuk lejohet asnje lloj tjeter veprimtarie tregtare pervec atyre qe ushtrohen ne kuader te kesaj Kontrate);

iii. Kohezgjatja: Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me afatin e kesaj Kontrate Koncesioni;

iv. Themelues i shoqerise: Shoqeria e re do te themelohet nga Koncesionari ne cilësine e ortakut/aksionerit te vetem.

2. Te paraqese prane Autoritetit Kontraktues, per miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga dita e hyrjes ne fuqi te kesaj kontrate.

3. Te marre te gjitha lejet dhe licensat e nevojshme per realizimin e kesaj kontrate ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

4. Te zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontrates;

5. Të marre masa që çdo investim te behet sipas afateve te percaktuar dhe me cilesinë e kërkuar në këtë Kontrate;

6. Të zbatoje projektin per ndërtimin e Hec-it me fuqi te vendosur jo më pak se 1,350 kW;

7. Të administroje projektin për periudhën e koncesionit;

8. Të kerkoje nese e gjykon me interes dhe te pershtatshme, zbatimin e detyrimit te Autoritetit Kontraktor sipas pikes 5 te nenit 7, me siper.

9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktor apo paleve te treta.

10. Të mbajë te informuar Autoritetin Kontraktues per çdo rrethanë që mund te kete ndikim në ecurine e projektit;

11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave te Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, te disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, te higjenës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.

12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;

13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noterale.

14. Koncesionari ka te drejte, kundrejt zgjedhjes se tij per shitjen e energjise qe i perket pjeses se tij te energjise elektrike te prodhuar nga hidrocentralet, po ashtu me qellim marrjen e certifikatave te gjelberta apo ndonje nxitje tjeter ekuivalente, qe ka te beje me prodhimet e energjive te rinovueshme, duke patur parasysh parashikimin e pikes 8 te ketij neni.

15. Ne kuader te zbatimit te punimeve per realizimin e projektit, bazuar ne ligjin nr. 8402, date 10.9.1998, "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" dhe Udhezimit te Keshillit te Ministrave nr. 3, date 15.2.2001, "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", Koncesionari eshte i detyruar te emeroje nje subjekt ne rolin e mbikqyresit te punimeve. Ai mund te jete person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencen perkatese per ushtrimin e kesaj veprimtarie.

## Neni 9
## Vleresimi i Investimeve

9.1 Mbi bazen e te dhenave te projektit, investimet qe duhet te kryhen nga koncensionari jane ne vleren totale prej 120,000,000 (njeqind e njezetmilion) leke, nga te cilat 57,000,000 (pesedhjete e shtatemilion) leke do te investohen ne makineri e pajisje, sipas Aneksit nr. 2.

9.2 Vleresimi i mesiperm mund te pesoje ndryshime te mundshme, me marreveshje ndermjet paleve:

- pas variantit perfundimtar te projektzbatimit
- ne cdo kohe gjate zbatimit te projektit ne ndertimin e vepres, sipas efektivitetit te ofertave

9.3 Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 120 000 000 (njeqindenjezetmilion) leke, por jo me e vogel se 114 000 000 (njeqindekatermbedhjetemilion) leke, qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne vleren 5% (pese) te investimit total te parashikuar.

## Neni 10
## Programi punimeve

Koncensionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

1. Konçesionari merr përsiper te fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjete) ditësh nga data e leshimit te lejes se ndertimit. Aplikimi per pajisjen me leje ndertimi do te kryhet brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e miratimit te projekt – zbatimit perfundimtar nga Autoritet Kontraktor.

2. Konçesionari merr përsiper të vërë në punë hidrocentralin brenda 14 (katermbedhjete) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur.

3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet perkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proçeduriale për marrjen e tyre.

4. Koha e shtyrjes do të jetë sa koha e vonesave te krijuara nga subjektet shtetërore.

## Neni 11
## Testimi i veprës

11.1 Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i vepres, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentralit. Testimi do te filloje brenda 30 (tridhjete) diteve nga marrja e njoftimit te bere nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.

11.2 Ky testim do te kryhet nën kontrollin e një grupi pune, ne përbërje te të cilit do te ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Konçesionarit, te cilet do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë te hidrocentralit, brenda 60 (gjashtedhjete) diteve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e vepres.

11.3 Ne rast mospjesmarrje te Autoritetit Kontraktor gjate testimit, Konçesionari ka te drejte te kryeje vete testimin dhe venien ne pune te vepres, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 (tridhjete) diteve nga testimi dhe venia ne pune.

## Neni 12
## Zgjidhja e Kontratës së Konçesionit

12.1 Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhe Kontratën e Konçesionit në mënyre të njëanshme, brenda 30 ditëve pasi të kete njoftuar per zgjidhjen palen tjeter:

1. Kur Konçensionari nuk fillon punën për 6 muaj (per shkak te tij) nga data e marrjes se lejes se ndertimit sipas nenit 10.1. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.

2. Në rast te mosrealizimit të fuqise së vendosur mbi 10 % te asaj sipas projektit të propozuar nga Konçesionari;

3. Kur Konçesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.

4. Kur Koncesionari braktis punimet e zbatimit per me shume se 100 (njeqind) dite te njepasnjeshme. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues ka te drejte te mare vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.

5. Kur shoqeria e te koncesionare eshte ne proces falimentimi (per faj te tij) dhe/ose likuidimi. Nese eshte e aplikueshme, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te mare vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.

6. Kur Koncesionari nuk zbaton ndonje apo te gjitha detyrimet e tij te parashikuara ne kete Kontrate.

12.2 Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palet bien dakord qe dorezimi do te behet brenda nje afati kohor prej 60 ditesh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.
Nese ky detyrim nuk permbushet nga Koncesionari atehere, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hec-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe te pandërprerë.

12.3 Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palen tjeter, kur permbushja e detyrimeve behet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë.

12.4 Pagesat ne rast zgjidhjeje te Kontrates :

1. Autoriteti Kontraktues, ne rast zgjidhjeje te Kontrates per faj te Koncesionarit, eshte i detyruar t'i paguaje ketij te fundit vleren aktuale te aseteve ne momentin e zgjidhjes. Megjithate Autoriteti ka te drejte nje mbaje nje vlere te barabarte me 20 (njezet) % nga kjo shume, si penalitet.

2. Autoriteti Kontraktues, ne rast zgjidhjeje te Kontrates sipas pikes 12.3 (me siper), eshte i detyruar t'i paguaje Koncesionarit nje vlere financiare te barabarte me vleren aktuale te mbetur te aseteve ne momentin e zgjidhjes.

12.5 Zgjidhja e kontrates me konsensus:

Palet kane të drejtë ta zgjidhin kontraten e koncesionit me pelqim te dyanshem, duke negociuar menyren e kompensimit të investimit. Gjithsesi, Koncesionari ka te drejte te kerkoje Sigurimin e Kontrates nese ekziston.

## Neni 13
## Kontratat

13.1 Konçesionari ka të drejte të lidhë kontrata sipermarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të konçesionit. Në të gjitha kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate konçesioni.

13.2 Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues per zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Konçesionari.

13.3 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsiper asnje detyrim kundrejt sipermarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, ne rast të mosmarrëveshjeve që mund te lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

## Neni 14
## Sigurimi i kontratës

14.1 Konçensionari, para nenshkrimit të kontratës, duhet të kete ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 12,000,000 (dymbedhjete milion) leke, qe perben 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit te kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkelidhet kësaj kontrate.

14.2 Konçensionarit i lejohet të ç'ngurtësoje kete vlerë, bazuar ne parashikimet e nenit 11, brenda 60 (gjashtedhjete) ditëve nga kryerja e testimit te veprës dhe venia ne pune.

14.3 Sigurimi i Kontrates do te sherbeje per te garantuar zbatimin ne menyren e duhur dhe brenda afatit te parashikuar, te detyrimeve te Koncesionarit ne lidhje me perfundimin e punimeve te ndertimit dhe perfundimin e testimit.

## Neni 15
## Sigurimet

15.1 Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithe kohezgjatjes se kontrates, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 8 te Ligjit 9267 dt.29.07.2004 "Për

veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje te tij çdo vit, brenda me afati 15 ditor nga data e sigurimit.

15.2 Në rast te dëmtimeve ne fazen e nderimit, apo gjate shfrytëzimit te objektit vlera e dëmit e kompensuar nga sigurruesi sipas kontratave perkatese te sigurimit duhet të përdoret për të rindertuar, riparuar, risistemuar dhe per të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para demtimit.

15.3 Koncesionari duhet të sigurojë pergjegjesine e tij per demtimet qe mund t'u shkaktohen paleve te treta per shkak te ushtrimit te veprimtarise.

15.4 Sigurimi do te kryhet per kufij pergjegjesie jo me te ulet se 200 000 Euro per cdo ngjarje dhe 500 000 Euro ne vit. Pjesa e zbritshme nuk mund te jete me e larte se 1000 Euro per cdo ngjarje dhe 2000 Euro ne vit.

15.5 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar ne te gjitha kontratat e sigurimit.

## Neni 16
## Tarifa konçesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa konçesionare

Konçesionari duhet te paguaje per llogari te Autoritetit Kontraktues nje tarife koncesinare te barabarte me vleren e 2 % të energjise elektrike të prodhuar në një vit.
Kjo tarifë nuk do te jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohezgjatjes së kontratës së konçesionit.

16.2 Vlera e riinvestimit

Çdo 15 vjet Konçesionari do të riinvestojë 40 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

## Neni 17
## Kufizime/Lejime

17.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek te tretet Konçesionari duhet te marrë pëlqimin paraprak te Autoritetit Kontraktues.

17.2 Konçesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra persipër me këtë kontratë, pervec se kur nje transferim i tille miratohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

17.3 Shoqeria e re qe do te krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Konçesionari ka te drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barre tjeter mbi asetet qe do te krijohen ne

zbatim te projektit te punimeve si dhe te bilhe cdo lloj marreveshje financimi me cdo Pale Financuese, me kusht qe hipoteka, pengu apo barra tjeter si dhe marreveshja perkatese e financimit t'i sherbeje permbushjes se detyrimeve te Koncesionarit ne kete Kontrate.

## Neni 18
## Raportimi

18.1 Konçesionari është i detyruar që çdo tre (3) muaj të raportojë me shkrim prane Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe cdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 19
## Legjislacioni i zbatueshem

19.1 Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Konçesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar..

## Neni 20
## Forca Madhore dhe ndryshimet ne ligj

20.1 Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabarte me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj te tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve, por duke patur parasysh se

(i) ngjarje te tilla nuk mund ose nuk mundej te parashikoheshin apo shmangeshin, pavaresisht kujdesit te arsyeshem te treguar nga pala e demtuar;

(ii) pala e demtuar mori ose kishte marre te gjitha masat paraprake e arsyeshme, per te shmangur pasojat e kesaj ngjarjeje, qe solli si pasoje paaftesine e kesaj pale per te permbushur detyrimet e Kontrates;

(iii) ngjarja nuk eshte ose nuk ishte, drejtepersedrejti ose jo, rezultat i ndonje mospermbushje detyrimesh te parashikuar ne kete Kontrate;

(iv) pala e demtuar ka derguar njoftim me shkrim pales tjeter, per ngjarjen e ndodhur, brenda 30 diteve nga ngjarja.

20.2 Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e permbushjes se detyrimeve në menyrë që të gjejnë një rrugë per të lehtësuar efektet e forces madhore dhe te vazhdojnë kontratën.

20.3 Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak te ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kerkesa reciproke per zhdemtim apo per respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijte e permbushjes se detyrimeve, do te percaktohen nga palët në marreveshje ndermjet tyre.

20.4 Ndryshimet ne Ligj

Cdo ndryshim i mundshem ne Ligj, i jep te drejten Koncesionarit te kerkoje sipas sipas pikes 8 e nenit 7 te kesaj Kontrate, kur keto ndryshime ndikojne drejtepersedrejti ne objektin e kesaj Kontrate dhe/ose jane diskriminuese.

## Neni 21
## Hyrja ne fuqi e Kontrates se Konçesionit

21.1 Kontrata e Koncesionit do te hyje ne fuqi mbasi te jete miratuar nga Keshilli i Ministrave te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me Ligjin Nr.9663, date 18.12.2006 "Per konçensionet".

## Neni 22
## Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

22.1 Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesioni, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

22.2 Kur me gjithë perpjekjet e palëve nuk arrihet nje konsensus i perbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konçesioni, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit, që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të Kodit te Procedures Civile të Republikës së Shqipërisë apo ndonje kuadri tjeter ligjor shqiptar.

22.3 Fillimi apo vazhdimi i negociatave per zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqesore te arbitrazhit nuk do të pezulloje zbatimin e projektit sipas objektit te kontrates dhe nuk do të çliroje palët nga detyrimet e marra përsiper me ane te kesaj Kontrate.

22.4 Zgjidhja e mosmarreveshjeve nepermjet procedures se arbitrazhit do te jete e zbatueshme vetem ne rast se nuk bie ndesh me ndonje rrethane, fakt apo ngjarje qe e ben te pamundur ekzekutimin e ketyre procedurave. Ne kete rast, mosmarreveshja do te jete objekt gjykimi nga gjykata e shkalles se pare Tirane.

## Neni 23
## Sanksionet

23.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve te kesaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 te kesaj kontrate, penalizon Konçensionarin si me poshte:

a. Për shkelje të afatit te ndërtimit 0,05 % në dite te vleres se investimeve te munguara.

b. Për moskryerje ne total te investimeve në vlerën e marrë përsipër ne konkurim, Konçesionari penalizohet me 10 % të vlerës se investimeve të parealizuara.

c. Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë.

Keto penalitete do te mbahen nga Sigurimi i Kontrates parashikuar ne nenin 14 me siper, duke patur parasysh se nese vlera e ketij sigurimi nuk eshte mjaftueshme per shlyerjen e penaliteteteve, Koncesionari do t'a plotesoje kete shume, rast pas rasti.

Ne rast zgjidhjeje te Kontrates perpara afatit te parashikuar per zhbllokimin e Sigurimit te Kontrates, penalitetet ne paragrafet a, b dhe c nuk do te aplikohen. Ne rast te kundert, Autoriteti Kontraktues zhbllokon Sigurimin e Kontrates, duke aplikuar penalitetet ne paragrafet a, b dhe c.

23.2 Mosrealizimi i prodhimit të energjise elektrike dhe fuqise se vendosur sipas kushteve të rëna dakort me kete kontrate, penalizon Koncesionarin si më poshtë:

a. Në rast mosrealizimi, për faj të Konçesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 8,400,000 KWh/vit, Konçesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, duke patur parasysh se ne kete rast Autoriteti Kontraktues do ta marre te plote tarifen koncesionare prej 2% (per sasi prej 8,400,000 KWh/vit). Ne rast kur prodhimi nuk realizohet per shkaqe te tjera (jo per faj te koncesionarit), Koncesionari paguan si tarife koncesionare vleren prej 2% te prodhimit te realizuar.

b. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Konçesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit te energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.

23.3 Palet bien dakord qe penalitetet e parashikuara ne paragrafet 23.2 do te zbatohen deri ne nje vlere prej 5,000,000 (pesemilion) leke. Sanksionet do te mbahen nga kjo vlere cdo fund viti kalendarik, sipas nje akti rakordimi te perbashket qe behet ndermjet paleve te kesaj Kontrate.

23.4 Mosparaqitja ne kohe e projektit te zbatimit per miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar ne nenin 8, pika 2 te kesaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% te vleres se investimit.

23.5 Sanksionet paguhen në llogari te Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.

23.6 Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoriteti Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditesh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohe, Autoriteti Kontraktues ka te drejtë që se bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore.

## Neni 24
## Rregullimi i shkeljeve

24.1 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së koncesionit Konçesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Konçesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.

24.2 Kjo procedurë nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërmbushja e detyrimeve.

## Neni 25
## Transferimi i Aseteve

25.1 Me mbarimin e Kontratës së Konçesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Koncesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Konçesionari në kantierin e Konçesionit, duhet të transferohen Autoritetit Kontraktues.

25.2 Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:

- Dorëzimin fizik të aseteve;
- Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asete;
- Kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Konçesionari.

25.2 Konçesionari duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

## Neni 26
## Mbarimi i kontratës

26.1 Kontrata konçesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4.

26.2 Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

## Neni 27
## Konfidencialiteti

27.1 Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një palë të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit

apo informacionit, pa miratimin e pales tjeter, pervecse per qellimin e permbushjes së kushteve të kesaj kontrate.

## Neni 28
## Ndryshime

28.1 Kjo kontratë mund te pesoje ndryshim, shtesa dhe/ose zevendesime vetem me marreveshje me shkrim të dy paleve.

28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkelidhur saj, do te hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikes së Shqipërise dhe do te jete pjese perbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

## Neni 29
## Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari jane zotuar te bashkepunojne ne menyre qe te garantojne realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim per çdo problem ndermjet paleve, do te behet vetem me shkrim, ne adresat e treguara me poshte nga palet. Palet jane te detyruara t'i njoftojne menjehere njera-tjetres çdo ndryshim te cilesdo prej ketyre koordinatave, brenda nje afati 10 (dhjete) ditor nga data e ndryshimit.

Per cdo ndihme qe do t'i kerkohet Autoritetit Kontraktues nga koncesionari, ky i fundit detyrohet te paraqese kerkesen me shkrim per çka kerkon ne zbatim te detyrimeve te kesaj Kontrate.
Adresat dhe numrat e fakseve zyrtare qe do te perdoren jane zbatimit te kesaj Marreveshje jane:

| Per Autoritetin Kontraktues | Per Koncesionarin |
|---|---|
| Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes<br>Blvd. Zogu i Pare, Nr. 1001,<br>Tirane - Shqiperi | Shoqeria "IRZ" sh.p.k.<br>Rruga "Don Bosko", Pallati perballe "parkut te autobuzeve",<br>Tirane - Shqiperi<br>Cel: + 355 (0) 692055992 |

## Neni 30
## Rregjistrimi i Kontrates

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kjo Kontrate duhet te rregjistrohet në rregjistrin e pasurive të paluajtshme.

## Neni 31
## Anekset

31.1 Kesaj Kontrate i bashkelidhen te gjitha anekset e permendura me siper, si dhe:

- Sigurimi i Kontrates, Seria Numer 0000137, date 28.01.2008;
- Autorizimi per nenshkrimin e Kontrates, Nr. 1597/5, date 13.02.2008.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashte) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet te lirë e te plote, dhe une noterja e vertetoj ate rregullisht sipas ligjit.

**PALET**

**AUTORITETI KONTRAKTUES**

**Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes**

**Perfaqesuar nga :**
**z. Kristo RODI**

Kristo Rodi

**KONCESIONARI**

**"IRZ" Sh.p.k.**

**Perfaqesuar nga :**
**Administratori z. Ramazan BIBA**

Fatmire Meta

GRAFIKU I PUNIMEVE PER NDERTIMIN E HEC SELISHTE
PESHKOPI

| Emertimi punimit/ muaji | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.Vepra e marjes | | | | | | | | | | | | | | |
| 2.Kanali i derivacionit | | | | | | | | | | | | | | |
| 3.Baseni me presion | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.Tubacioni i turbinave | | | | | | | | | | | | | | |
| 5.Ndertesa e centralit | | | | | | | | | | | | | | |
| 6.Kanali i largimit ujrave | | | | | | | | | | | | | | |
| 7.Linja shperndarese e TL | | | | | | | | | | | | | | |
| 8.Paisje makineri elektrike | | | | | | | | | | | | | | |
| 9.Te tjera | | | | | | | | | | | | | | |

NOTER
TIRANE

Per Shoqerine "I.R.Z." shpk
Drejtuesi ligjor

Ramazan B

# PREVENTIVI PARAPRAK

## HIDROCENTRALI SELISHTE

| Nr. | Emertimi i punimit | | Vlera (leke) |
|---|---|---|---|
| 1 | VEPRA E MARRJES | | |
| 1.1 | Germime dheu dhe shkembi | | 36,480 |
| 1.2 | Mbushje me dhe | | 2,750 |
| 1.3 | Betone M 150 | | 435,000 |
| 1.4 | Hekur beton gjithsej, rrjeta metalike | | 71,750 |
| | | SHUMA 1 | 546,980 |
| 2 | KANALI I DERIVACIONIT L=3255 + Dekantuesi | | |
| 2.1 | Germime dheu , shkemb I bute, shkemb kompakt | | 2,277,750 |
| 2.2 | Shtrese zhavorri | | 320,000 |
| 2.3 | Shtresa e kanalit, veshje mure beton M200, mure mbajtes | | 8,850,000 |
| 2.4 | Hekur beton, tub hekuri, llamarine xingato | | 2,991,000 |
| | | SHUMA 2 | 14,438,750 |
| 3 | BASENI ME PRESION | | |
| 3.1 | Germime dheu , shkemb I bute, shtrese zhavorri | | 118,100 |
| 3.2 | Beton M-200 | | 984,000 |
| 3.3 | Hekur betoni, tuba , llamarine, rrjeta metalike , te tjera | | 592,750 |
| | | SHUMA 3 | 1,694,850 |
| 4 | TUBACIONI I TURBINAVE | | |
| 4.1 | Germime dheu , shkemb / bute, shtrese zhavorri | | 195,100 |
| 4.2 | Betone mbeshtetese | | 802,600 |
| 4.3 | Hekur, llamarine hekuri, tubacione | | 5,264,910 |
| | | SHUMA 4 | 6,262,610 |
| 5 | NDERTESA E CENTRALIT | | |
| 5.1 | Germime dheu dhe shkembi , mbushje dheu | | 96,400 |
| 5.2 | Betone M-200 | | 870,000 |
| 5.3 | Hekur betoni, mur guri, solete b/a | | 5,250,000 |
| | | SHUMA 5 | 6,216,400 |
| 6 | KANALI I LARGIMIT TE UJRAVE | | |
| 6.1 | Zbarkim dheu, germim shkemb | | 36,650 |
| 6.2 | Shtrese zhavorri dhe betonim kanali | | 155,200 |
| | | SHUMA 6 | 191,850 |
| 7 | LINJA SHPERNDARESE E TENSIONIT TE LARTE | | |
| 7.1 | Germime dheu, shtrese zhavorri, betonim | | 239,900 |
| 7.2 | Shtylla te tensionit 10 kv, linja , punime lidhje me rrjetin | | 1,610,120 |
| | | SHUMA 7 | 1,850,020 |
| 8 | TE TJERA | SHUMA 8 | 12,724,844 |
| | | SHUMA (1+2+3+4+5+6+7+8) | 43,926,304 |
| | 20 % tvsh | | 8,785,261 |
| | | SHUMA | 52,711,565 |
| | Rezerve afersisht 14 % | | 7,288,435 |
| | | SHUMA | 60,000,000 |
| 9 | PAJISJE MAKINERI ELEKTRIKE | | 57,000,000 |
| 10 | [illegible] | | 3,000,000 |

| | | |
|---|---|---|
| | | |
| | | 120,000,000 |

ADMINISTRATORI

RAMAZAN BIBA

Selishte

# PAISJET KRYESORE HIDROMEKANIKE DHE ELEKTRIKE TE HIDROCENTRALIT

| r | Emertimi I paisjes | Njesia | Sasia | Vrejtje |
|---|---|---|---|---|
| | Turbine e tipit "FRENSIS" me fuqi 650 kw me ( Q=1 m3/sek, H=80-85 m) se bashku me gjeneratorin me fuqi 750-800 kw si dhe te gjitha paisjet hidromekanike dhe elektrike perkatese | cope | 2 | |
| | Transformator me fuqi 800 kw se bashku me anekset e tjera elektrike | cope | 2 | |
| | Vinxh TAL me kapacitet 2,5 ton I kompletuar me paisjet e tjera | cope | 1 | |
| | Panele elektrike kontrolli e komandimi | cope | 2 | |

## KONSTRUKSIONET METALIKE ME KRYESORE

| | Emertimi I paisjes | Njesia | Sasia | Vrejtje |
|---|---|---|---|---|
| | Porte metalike (b= 1,5 m h=1,2m) se bashku me mekanizmin ngrites | cope | 1 | |
| | Porte metalike e rrafshet 1,2m x 1,2m bashke me mekanizmin ngrites | cope | 2 | |
| | Porte remonti e rrafshet 1,2m x1,2m bashke me mekanizmin ngrites | cope | 2 | |
| | Porte metalike e rrafshet 1,6m x 1,6m se bashku me mekanizmin ngrites | cope | 2 | |
| | Rrjete metalike 1,5mx1,5m | cope | 2 | |
| | Kompesator per tubat metalik me diameter D=630 mm dhe presion 10 atmosfere | cope | 8 | |
| | Saracinesk me D=200 mm | cope | 1 | |
| | Zgara metalike 1,0x2m | cope | 3 | |

PASQYRA NR 4

KOSTO E PLOTE E PROJEKTIT H.E.C SELISHT DIBER

| ZERAT E INVESTIMEVE | | | Kostoja e plote | Burimet e financimit | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Hua | Kapital |
| | | Investimet afat gjata | | | |
| I | | Truall | 5000000 | 0 | 5000000 |
| | | Shuma I | 5000000 | 0 | 5000000 |
| II | | Punime civile | | | 0 |
| | 1 | Ndertimi I vepres marrjes | 929866 | | 929866 |
| | 3 | Ndertimi I kanalit te derivacionit | 24545875 | 20000000 | 4545875 |
| | 4 | Ndertimi I basenit te presionit | 2881245 | | 2881245 |
| | 5 | Ndertesa e centralit | 10894025 | 10000000 | 894025 |
| | 6 | Rruge provizore | 8500000 | 8000000 | 500000 |
| | 7 | Tubacionete turbines ,konstr.met | 10646437 | 6000000 | 4646437 |
| | | | | | 0 |
| | | Shuma II | 58397448 | 44000000 | 14397448 |
| III | | Punime elektrike | | | 0 |
| | | Ndertimi I linjes T/L 10 kw. | 3145034 | 2000000 | 1145034 |
| | | Shuma III | 3145034 | 2000000 | 1145034 |
| IV | | Makineri e paisje | | | 0 |
| | 1 | Agregat me aksesor | 37000000 | 26000000 | 11000000 |
| | 2 | Punime montimi | 2000000 | | 2000000 |
| | 3 | Asistence teknike | 2000000 | | 2000000 |
| | | | | | 0 |
| | | | | | 0 |
| | | Shuma IV | 41000000 | 26000000 | 15000000 |
| V | | Shpenzime per fillim aktiviteti | | | 0 |
| | 1 | Projekt idea | 500000 | | 500000 |
| | 2 | Projekt zbatimi | 2400000 | | 2400000 |
| | 3 | Hartimi I plan biznesit | 100000 | | 100000 |
| | 4 | Studim Hidrollogjik | 80000 | | 80000 |
| | 5 | Studim gjeologjik | 60000 | | 60000 |
| | 6 | Udhetim e dieta | 360000 | | 360000 |
| | 7 | Te tjera dokumente | 500000 | | 500000 |
| | 8 | Shpenzime krijim shoqerie | | | 0 |
| | 9 | Kordinator projekti | | | 0 |
| | | | | | 0 |
| | | Shuma V | 4000000 | 0 | 4000000 |
| | | | | | 0 |
| | | RZERVA | 8457518 | | 8457518 |
| KOSTOJA TOTALE E PROJEKTIT | | | 120000000 | 72000000 | 48000000 |

€EUROSIG
KOMPANI SIGURIMESH

Rr. Lek Dukagjini Nr. 5 Tiranë, Shqipëri
Tel: 00355 4 238999 / 238999 Fax: 00355 4 223841 Cel: 00355 69 20 70 659 E-mail: info@eurosig.al www.eurosig.al

Seria 0000137

# FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Ref. ____________

Data 28.01.2008

Për: [illegible] Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes
(Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor)

Në emër të: [illegible]
(Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar)

Procedura e prokurimit (*nëse zbatohet*): ____________
(Referenca e dosjes nga autoriteti kontraktor)

Përshkrimi i shkurtër i kontratës Dhenie me koncension te HEC-it "Selishte dhe Fenatir"
(Lloji procedurës dhe objekti)

Publikimi (*nëse zbatohet*) Buletini i Njoftimeve Publike nr Selishte, date Komune Selishte Rrethi Diber

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, dhe me kusht që [illegible]
(emri i ofertuesit të përcaktuar fitues)

t'i jetë akorduar kontrata, ne vertetojmë se [illegible] ka derdhur
(emri i ofertuesit të përcaktuar fitues)

një depozitë pranë Shoqërisë Sigurimeve "EUROSIG" sh.a., në një shumë prej:

Lekë [illegible] (dymbedhjete milion leke)
(shuma me fjalë)

si kusht për garantimin e ekzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me
[illegible] Tregtise dhe Energjitikes
(Emri autoritetit kontraktor)

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [illegible] Ekonomise Tregtise dhe
(Emri autoritetit kontraktor)

Vlerën e siguruar brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës

Lëshuar në [illegible] më [illegible] 200__

SHOQERIA E SIGURIMEVE " EUROSIG" sh.a.
Përfaqësuesi ____________
(Emri, mbiemri, firma, vula)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

Nr. 1347/5 prot.

Tirane, me 13.02.2008

# AUTORIZIM

Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 7850, date 29.07.1994 "Per Kodin Civil ne Republiken e Shqiperise", Titulli II, Kreu I (Perfaqesimi) dhe te ligjit Nr. 9663, date 18.12.2006 "Per koncesionet", autorizoj Z. Kristo Rodi, Drejtor i Drejtorise se Pergjithshme Rregullatore, te nenshkruaje ne emer te Ministrit te Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes kontraten e koncesionit (forma "BOT") me shoqerine "IRZ" sh.p.k, per hidrocentralin "Selishtë".

MINISTRI

GENC RULI